



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT**

**PËR**

**MONITORIMIN E PROCESIT TË RISTRUKTURIMIT NË**

**MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

**Tiranë, Tetor 2018**

## RAPORT

### **Për përmbylljen e procesit të monitorimit në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil, gjatë procesit të ristrukturimit, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë**

#### **Hyrje**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nëpërmjet urdhrinr. 85, datë 09.10.2017, “Për fillimin e monitorimit të zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të akteve nënligjore, gjatë aplikimit të procedurave në lidhje me procesin e riorganizimit të institucioneve të administratës shtetërore (mbylljes dhe ristrukturimit), pas miratimit të përbërjes së Këshillit të Ministrave”, ka vendosur fillimin e monitorimit të zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të akteve nënligjore, gjatë aplikimit të procedurave të ristrukturimit të aparatit të Këshillit të Ministrave dhe Ministrive të linjës.

Bazuar në pikën 6, të tabelës nr. 1, bashkëlidhur urdhrinr më sipër, u ngrit grupi i punës me përbërje inspektorët, Gentiana Agushi dhe Alda Xhaxhiu, të cilët janë autorizuar nga Komisioneri për të monitoruar procesin e ristrukturimit në Ministrinë e Mbrojtjes, i cili filloi në datën 06.02.2018.

Objekti i monitorimit në këtë institucion është procedura e ristrukturimit, që përfshin të gjitha proceset e legjislacionit për nëpunësin civil, që rregullojnë këtë aspekt, ndër të cilat përmendim, hartimin e përshkrimeve të reja të punës; krijimin e Komisionit të Ristrukturimit; veprimtaria e Komisionit të Ristrukturimit, aktet administrative për propozimin e transferimeve të Komisionit të Ristrukturimit; verifikimi i propozimeve për sistemimin e nëpunësve dhe miratimi i tyre nga Departamenti i Administratës Publike; evidentimi i rasteve të lirimit nga shërbimi civil, respektimi i afateve procedurale nga ana e aktorëve që marrin pjesë në këtë procedurë, etj.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i punës përpunoi të dhënat dhe përgatiti raportin e monitorimit në lidhje me administrimin e shërbimit civil, gjatë aplikimit të procedurave të ristrukturimit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si më poshtë:

#### **Qëllimi i monitorimit**

Qëllimi i realizimit të këtij procesi është:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”; si dhe Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të

Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”.

- Paraqitja e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil para përgjegjësve për administrimin e procesit të ristrukturimit.
- Paralajmërimin e njësisë përgjegjëse, institucionit dhe personave përgjegjës, në rast të konstatimit të parregullsive gjatë zbatimit të ligjit, duke lënë detyrat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

### **Metodologjia e monitorimit**

Si metodë pune shtë përdorur verifikimi i dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në sektorin e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, si dhe Departamentit të Administratës Publike. Konkretisht, grupi i punës realizoi veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht u organizua një takim dhe bashkëbisedim, në datën 06.2.2018, me \*\*\*\*\*\*, me detyrë “Sekretar i Përgjithshëm” i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me të cilin u diskutua mbi objektin dhe drejtimit e procesit, si dhe u ra dakord në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhej të vihej në dispozicion të grupit të punës për verifikim. Person i kontaktit me grupin e punës në këtë institucion, u caktua nëpunësja \*\*\*\*\*\*, e cila kryen detyrën “Specialiste e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve,” në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
- U administrua gjithë dokumentacioni shkresor i konsideruar i nevojshëm për realizimin e këtij monitorimi, e konkretisht: struktura aktuale dhe struktura mëparshme; listëprezencat para dhe pas ristrukturimit; disa modele të formatit të përshkimeve të punës; dokumentacioni që materializon procedurën e ristrukturimit; aktet administrative që materializojnë vendimmarrjen e Komisionit të Ristrukturimit dhe të Departamentit të Administratës Publike; si dhe çdo dokumentacion tjetër që ndihmon realizimin e verifikimit të procesit.

### **Përmbajtja e Raportit:**

Me miratimin e përbërjes së Këshillit të Ministrave, që përkon me mbarimin e procesit zgjedhor të vitit 2017, rezulton se është riorganizuar i gjithë aparati shtetëror. Nga ky proces, u shkrinë 8 ministri të mëparshme, funksionet e të cilave iu bashkuan 11 ministrive të mbetura, si dhe u shtuan 2 ministri të reja, duke e reduktuar numrin nga 19 ministri, që ishin para zgjedhjeve, në 13 ministri.

Për pasojë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila është subjekt i këtij monitorimi, si dhe gjithë ministrinë të tjera, kaluan në proces ristrukturimi.

Në përfundim të procesit të monitorimit rezultoi si më poshtë:

## **I. Analiza e Procesit të Ristrukturimit**

Me konstituimin e përbërjes së Këshillit të Ministrave, pas procesit zgjedhor (*Qershor, viti 2017*), u miratuan, aktet nënligjore që përcaktojnë fushën e përgjegjësisë së ministrive të linjës.

Në lidhje me veprimtarinë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, ka dalë vendimi nr. 504, datë 13.09.2017, i Këshillit të Ministrave “*Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë*”.

Më tej, me urdhrin nr. 160, datë 05.10.2017, të Kryeministrit “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë*”, është miratuar struktura dhe organika e re, sipas skemës 1 e 2, bashkëlidhur këtij urdhri.

### ***I. Analiza e ndryshimeve të Strukturës Organizative.***

#### ***a) Struktura e re Organizative***

Nga krahasimi i strukturës organizative aktuale me strukturën organizative të mëparshme, rezulton se institucioni është riorganizuar duke ndryshuar rrënjësisht mënyrën e organizimit strukturor të njësive të tij organizative (*Drejtorive të Përgjithshme, Drejtorive dhe Sektorëve*), e cila është pasuar me ndryshim të skemës organizative, të hierarkisë e llogaridhënies, të emërtesave, të përbërjes dhe të nivelit të kategorive të pagës të pozicioneve të punës.

Nga analiza e strukturës së re organizative, u konstatua se, institucioni ka aplikuar një qasje drejt një organizimi të ri, duke e ndërruar aparatën nën varësinë e Sekretarit të Përgjithshëm, në tre shtylla kryesore që kanë të bëjnë me:

- ✓ politikat dhe zhvillimin e sektorëve nën fushën e përgjegjësisë;
- ✓ aspektin rregullator dhe përputhshmërinë në sektorët që mbulojnë; dhe,
- ✓ aspektin ekonomik dhe shërbimet mbështetëse,

të cilave i përgjigjen respektivisht tre njësi të strukturës:

- ✓ Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Mbrojtjes;
- ✓ Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Fushën e Mbrojtjes;
- ✓ Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Ndarja në nivelin e parë (*Drejtori e përgjithshme*), vijon më tej me ndarjen në nivelin e dytë, Drejtori dhe rezulton se çdo Drejtori e Përgjithshme ndahet në disa Drejtori, nën varësinë e të cilave vijon niveli i tretë, i cili grupohet mbi bazën e Sektorit.

Pra, ashtu si vërehet, është krijuar një model i ri i organizimit funksional, me ndryshime konceptuale, e cila synon minimizimin e parcelizimit të strukturës dhe pasojave që vijnë prej saj, konfliktet, harxhimin e burimeve, zbehjen e funksioneve të planifikimit, mospasje kapacitetesh etj. Po kështu, kjo strategji është ndjekur me qëllim që të unifikohet mënyra e organizimit të aparateve ekzekutive, të thjeshtohet struktura, të shmangen funksionet e përsëritura, si dhe për të nxjerrë në pah funksionet prioritare që ka institucioni.

***b) Krahasimi i strukturës aktuale, me strukturën e mëparshme në lidhje me ndryshimet e numrit të përgjithshëm dhe të statusit të pozicioneve të punës.***

Në kushtet specifike të krijuara pas miratimit të strukturës së re sipas urdhrit nr. 160, datë 05.10.2017, të Kryeministrit “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë*”, ku vihet re një reformim i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, kjo gjë është shoqëruar me mbylljen e 3-ish ministrive.

Konkretisht, po japim në mënyrë të detajuar strukturën dhe organikën e 3 ministrive, para shkrirjes dhe ristrukturimit në ministrinë aktuale, si më poshtë:

➤ ***Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës***

Ky institucion funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 160, datë 27.03.2014, “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës*”. Sipas kësaj strukture, konstatohet se, institucioni në fjalë, ka pasur **97 pozicione pune si pjesë e shërbimit civil**, nga të cilat **20 vende pune kanë qenë të lira**.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, **97** pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, ndahen në këtë mënyrë:

✓ *Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues* janë **5** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicioneve

▪ 1 “*Sekretar i Përgjithshëm*”

▪ 4 “*Drejtor i Përgjithshëm*”,

rreth **5%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.

✓ *Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues* janë **10** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “*Drejtor Drejtorie*”, rreth **10%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.

- ✓ Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **20** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicioneve
  - 17 “Përgjegjës Sektori/kategoria e pagës III/a”,
  - 3 “Përgjegjës Sektori/kategoria e pagës III/a-1”,
 rreth **21%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.

- ✓ Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **62** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicioneve
  - 50 “Specialist/kategoria e pagës III/b”,
  - 10 “Specialist/kategoria e pagës IV/a”,
  - 2 “Specialist/kategoria e pagës IV/b”,
 rreth **64%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.

### ➤ **Ministria e Energjisë dhe Industrisë**

Ky institucion funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 35, datë 12.03.2015, i ndryshuar “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë”. Sipas kësaj strukture, konstatohet se, institucioni në fjalë, ka pasur **99 pozicione pune si pjesë e shërbimit civil**, nga të cilat **27 vende pune kanë qenë të lira**.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, **99** pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës, ndahen në këtë mënyrë:

- ✓ Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues janë **2** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicioneve
  - 1 “Sekretar i Përgjithshëm”
  - 1 “Drejtor i Përgjithshëm”,
 rreth **2%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.

- ✓ Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues janë **11** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Drejtor Drejtorie”, rreth **11%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.

- ✓ Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **21** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicioneve
  - 18 “Përgjegjës Sektori/kategoria e pagës III/a”,
  - 3 “Përgjegjës Sektori/kategoria e pagës III/a-1”,
 rreth **21%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.

- ✓ Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **65** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicioneve
  - 62 “Specialist/kategoria e pagës III/b”,
  - 1 “Specialist/kategoria e pagës IV/a”,

- 2 “Specialist/kategoria e pagës IV/b”,  
rreth **66%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.

➤ **Ministria e Zhvillimit Urban**

Ky institucion funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 29, datë 27.02.2015, i ndryshuar “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Zhvillimit Urban”. Sipas kësaj strukture, konstatohet se, institucioni në fjalë, ka pasur gjithsej **91 pozicione pune vlerësohen si pjesë e shërbimit civil**, nga të cilat **18 vende pune kanë qenë të lira**.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, **91** pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në Ministrinë e Zhvillimit Urban, ndahen në këtë mënyrë:

- ✓ Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues janë **2** pozicione pune, të cilati përkasin pozicioneve
  - 1 “Sekretar i Përgjithshëm”
  - 1 “Drejtor i Përgjithshëm”,

rreth **2%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.

- ✓ Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues janë **11** pozicione pune, të cilati përkasin pozicionit “Drejtor Drejtorie”, rreth **12%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.

- ✓ Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **21** pozicione pune, të cilati përkasin pozicioneve
  - 18 “Përgjegjës Sektori/kategoria e pagës III/a”,
  - 3 “Përgjegjës Sektori/kategoria e pagës III/a-1”,

rreth **23%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.

- ✓ Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **57** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicioneve
  - 47 “Specialist/kategoria e pagës III/b”,
  - 6 “Specialist/kategoria e pagës IV/a”,
  - 4 “Specialist/kategoria e pagës IV/b”,

rreth **63%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.

- **Mbas restrukturimit si procesi që ka bashkuar institucionet e analizuarra më sipër, strukturimi i pozicioneve në shërbimin civil në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, paraqitet si më poshtë:**

Momentalisht, ky institucion funksionon mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 160, datë 05.10.2017, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”. Sipas kësaj strukture, konstatohet se, institucioni në fjalë, në momentin e verifikimit ka gjithsej **272** pozicione pune, të cilat ndahen në këtë mënyrë:

- **16** pozicione pune janë funksione politike,
- **240** pozicione pune, konsiderohen pjesë e shërbimit civil, që zënë rreth 88% të numrit total të pozicioneve të punës,
- **16** pozicione pune që kryejnë funksione administrative.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, **240** pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ndahen në këtë mënyrë:

- ✓ Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues janë **5** pozicione pune, të cilati përkasin pozicioneve
  - 1 “Sekretar i Përgjithshëm”
  - 4 “Drejtor i Përgjithshëm”,rreth **2%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.
  
- ✓ Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues janë **14** pozicione pune, të cilati përkasin pozicionit “Drejtor Drejtorie”, rreth **6%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.
  
- ✓ Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **50** pozicione pune, të cilati përkasin pozicioneve
  - 47 “Përgjegjës Sektori/kategoria e pagës III/a”,
  - 3 “Përgjegjës Sektori/kategoria e pagës III/a-1”,rreth **20%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.
  
- ✓ Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **171** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicioneve
  - 160 “Specialist/kategoria e pagës III/b”,
  - 4 “Specialist/kategoria e pagës IV/a”,
  - 7 “Specialist/kategoria e pagës IV/b”,rreth **71%** e numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.



Nisur nga analiza e realizuar më sipër, Komisioneri arrin në konkluzionin se, me miratimin e strukturës së re, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka kaluar në një proces të thellë ristrukturimi, për arsye të përfshirjes në një të vetme të 3-ish ministrive.

## **II. Analiza e procesit të ristrukturimit**

Instituti i ristrukturimit rregullohet në mënyrë të hollësishme në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; vendimin nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”; si dhe udhëzimin nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”.

Në këto dispozita përcaktohen në mënyrë specifike aktorët që marrin pjesë gjatë një procedure ristrukturimi, kompetencat për vendimmarrje dhe procedura që duhet ndjekur deri në finalizimin e këtij procesi.

Në kuadër të drejtimeve të mbikëqyrjes, u verifikua dokumentacioni i vënë në dispozicion në lidhje me procedurën e ristrukturimit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, nga analiza e të cilit rezultoi si më poshtë vijon.

### **a) Përshkrimet e punës**

Nisur nga përmbajtja e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, Komisioni i Ristrukturimit shqyrton mundësinë e sistemimit apo transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë, në vendet e lira apo të reja të krijuara, mbështetur në analizën e kritereve specifike të pozicioneve të punës dhe të dhënave të nëpunësve civilë.

Në zbatim të Kreut IV, pika 13, germa “ç”, të vendimit nr. 142, datë 13.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, kërkesat e veçanta për çdo pozicion pune në shërbimin civil, përcaktohen tek përshkrimet e punës.

Më tej në pikën 14, të po këtij akti nënligjor, përcaktohet se: “Përshkrimet e punës hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit apo kur kanë ndodhur ndryshime ose miratime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni”.

MeUrdhrin e Kryeministrit nr. 160, datë 05.10.2017, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, administrata e institucionit të mbikëqyrur ka kaluar në proces ristrukturimi. Në këtë kuadër konstatohet ndryshim i misionit të institucionit, shkrirje e bashkim i

strukturave, shtim dhe riorganizim i pozicioneve të punës, etj., gjë e cila nënkupton që ky proces ristrukturimi, duhej të paraprihej nga hartimi i përshkrimeve të reja të punës. Por, në rastin konkret vërehet se në këtë drejtim nuk është punuar sipas formatit të përcaktuar në aktin nënligjor që rregullon këtë aspekt të procesit.

Konkretisht, Departamenti i Administratës Publike në momentin e fillimit të procedurës së ristrukturimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për të kapërcyer ngërçin që do të krijohej nga mos hartimi në kohë i përshkrimeve të punës, ka kërkuar nëpërmjet postës elektronike, dërgimin e kriterëve të veçanta të pozicioneve të shërbimit civil, sipas strukturës organizative të ministrisë në fjalë, të cilat i janë vënë në dispozicion nga institucioni, ku rezulton të jenë përcaktuar kriteret në lidhje me përvojën dhe kriterin arsimor.

Pra, në momentin e ristrukturimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nuk kanë qenë të përfunduara formularët e përshkrimit të punës (*të cilat aktualisht janë në fazën e hartimit dhe të nënshkrimit të tyre*). Grupi i punës këtë rast e vlerëson si parregullsi në administrimin e shërbimit civil, për arsye se ligji specifik që rregullon këtë aspekt kërkon që procesi i hartimit të përshkrimeve të punës duhet të përfundojë përpara se të fillojë procesi ristrukturimit.

Por nga ana tjetër, konstatohet se për të gjitha rastet, janë ekstraktuar kërkesat e posaçme për çdo pozicion pune, sipas kushteve të reja të krijuara, të cilat i kanë shërbyer Komisionit të Ristrukturimit për të vlerësuar përmbushjen e tyre nga punonjësit aktual.

*Përshkrimet e reja të punës, duke vlerësuar kompleksitetin e procesit, kërkojnë një angazhim të madh nga aktorët e ngarkuar prej ligjit për të hartuar këto akte, të cilët fillimisht duhet të pozicionohen në këto vende në rolin e eprorit direkt.*

Në këtë rast, vlerësohet se kjo parregullsi është krijuar për rrethana objektive dhe nuk është e asaj natyre që të cenojë gjithë procesin për arsye se informacioni bazë për të realizuar procesin e ristrukturimit, i tillë si detyrat organike dhe kriteret e veçanta që kërkohen për çdo pozicion pune pjesë e shërbimit civil, rezulton se ishin përcaktuar përpara se procesi i ristrukturimit të fillonte. Por, kjo problematikë është evidentuar nga grupi i punës, në mënyrë që të përfundojnë përshkrimet e punës dhe në të ardhmen, aktorët që marrin pjesë në këtë proces, të përmirësojnë administrimin e shërbimit civil gjatë aplikimit të procesit e ristrukturimit.

#### ***b) Krijimi i Komisionit të Ristrukturimit dhe procedura e realizuar prej tij***

Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, me urdhrin nr. 104/5, datë 09.10.2017, “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, ka krijuar Komisionin e Ristrukturimit të përbërë nga:

- \*\*\*\*\* (kryetar i komisionit), me detyrë “Specialist”, në Sektorin e Procedurave të Rekrutimit, në Drejtorinë e Politikave të Rekrutimit të Administratës Publike, në cilësinë e përfaqësueses së njësishë përgjegjëse (DAP);
- \*\*\*\*\* (anëtar), me detyrë “Sekretar i Përgjithshëm”, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e nëpunësit më të lartë civil të ministrisë;
- \*\*\*\*\* (anëtare), me detyrë “Specialiste e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në ish-Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë”.

Konstatohet që në këtë rast nuk është vepruar në përputhje të plotë me Udhëzimin nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin, përbërjen dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”, ku në pikën 2, germa “a/1” të tij, përcaktohet se në rastet e bashkimit/mbylljes/shkrirjes, së ministrive, Komisioni i Ristrukturimit përbëhet nga 3 anëtar, si më poshtë:

- Një përfaqësues nga njësia përgjegjëse (DAP);
- 2 përfaqësues të ministrive që preken nga procesi, të përzgjedhur nga njësia përgjegjëse (DAP) ndërmjet radhëve të nëpunësve civilë, të ministrive që preken.

Komisioni është kujdesur që të respektohen kërkesat ligjore në përbërjen e tij, i cili, bazuar në pikën 7 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ka të drejtë të propozojë sistemimin dhe trajtimin financiar për të gjithë nëpunësit të cilët do të largohen për shkak të ristrukturimit, duke krahasuar përshkrimin e punës, kërkesat specifike, si dhe çdo kërkesë tjetër që rrjedh nga dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë rast, për çdo pozicion që nuk ekziston më. Në këtë rast duhet të jetë në vëmendjen e njësishë përgjegjëse, Udhëzimi nr. 1, datë 01.03.2016 i Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”, ku përcaktohen qartë rregullat e përgjithshme për krijimin dhe funksionimin e këtij mekanizmi.

Në realizimin e këtij procesi, Komisioni i Ristrukturimi ka marrë parasysh përputhshmërinë e të dhënave individuale të nëpunësve me kërkesat e posaçme të vendeve të punës të ristrukturuar apo të krijuara, si dhe vjetërsinë në punë në pozicionin aktual, kjo e bazuar edhe në përshkrimet e punës, të cilat janë dërguar në sistemin “online”, pranë Departamentit të Administratës Publike, sipas formularit të përcaktuar nga dispozita ligjore, por ende nuk janë materializuar në formën e kërkuar nga ligji.

Vlerësojmë se, dispozitat që rregullojnë institutin e ristrukturimit, në rastet kur për shkak ristrukturimi pozicioni i punës nuk ekziston më, apo nuk përmban karakteristikat e mëparshme, shprehen vetëm për detyrimin e njësishë përgjegjëse, për ruajtjen e kategorisë së pozicionit të punës, sipas konceptimit që i bën këtij elementi të marrëdhënies së punës në shërbimin civil, pika 2, e nenit 19, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar. Në këtë vështrim, në rastin e transferimit për shkak të ristrukturimit të pozicionit të punës, të një nëpunësi civil të kategorisë ekzekutive, sipas ligjit, ekziston detyrimi që

pozicioni i ri i punës ku do të transferohet, të jetë gjithashtu pozicion i kategorisë ekzekutive, pa u lidhur me ndonjë detyrim të një natyre tjetër, si paga, kushtet e punës, etj.

Problemi i pagesës dhe niveleve të pagës, rregullohet nga neni 34, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar. Në pikën 2 të tij, përcaktohen përbërësit e pagës: “Paga e nëpunësit civil përbëhet nga paga bazë e kategorisë, shtesa për klasën së cilës i përket pozicioni, dhe shtesa për kushtet e punës” dhe në pikën 4, të po këtij neni, përcaktohet kompetenca e organit që përcakton strukturën dhe nivelin e pagës për çdo pozicion. Në ‘të thuhet shprehimisht: “Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore për strukturën dhe nivelet e pagave sipas këtij neni”, kompetencë e cila materializohet, për çdo rast dhe institucion, nëpërmjet urdhrave të Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave.

Ky është kuptimi që i jep ligji detyrimeve të institucionit për ruajtjen e statusit të nëpunësve civilë, në rastet kur pozicionet e tyre preken nga ristrukturimi. Nisur nga parimi kushtetues, i shpërblimit sipas sasisë dhe cilësisë së punës, kuptohet që një nëpunës kur pranon të punojë në një pozicion pune të shërbimit civil, qoftë në momentin e pranimit në shërbimin civil, ashtu dhe në rastin e transferimit në një pozicion tjetër të të njëjtës kategori, për shkaqe ligjore, është i detyruar të marrë parasysh që, do të paguhet sipas pagës së përcaktuar nga organi kompetent për atë pozicion pune. Organi kompetent për përcaktimin e pagës për pozicionet e punës është Këshilli i Ministrave, i cili nxjerr aktet e nevojshme nënligjore për strukturën dhe nivelet e pagave, të cilat siç u tha dhe më lart, materializohen nëpërmjet urdhrave të Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagës për çdo institucion dhe pozicion konkret pune.

Propozimet e Komisionit të Ristrukturimit, për lirim nga shërbimi civil, të atyre nëpunësve, pozicioni i të cilëve nuk ekziston më, apo është riorganizuar, kompetencë e tij që është e parashikuar në pikën 3 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe në Vendimin 125, datë 17.02.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”.

Në zbatim të pikës 7, Kreu II, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të Institucionit” të Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, Komisioni i ristrukturimit duhet që brenda 15 ditëve nga data e ristrukturimit, të bëjë propozimet përkatëse.

Konkretisht Komisioni i Ristrukturimit të MIE-së, pasi ka marrë në shqyrtim strukturat dhe organikat ekzistuese të të 3 ish-ministrive, strukturën dhe organikën e re të MIE, të dhënat e nëpunësve civilë, vendet e të cilëve preken si pasojë e ristrukturimit (dosjet individuale), kriteret specifike të vendeve të lira apo të krijuara/prekura si pasojë e ristrukturimit, vlerësoi mundësitë për transferimin e përhershëm të nëpunësve civilë në strukturat organizative të MIE, për të cilat nuk ka ndryshime dhe i bëri propozimet përkatëse DAP në cilësinë e Njësisë Përgjegjëse.

Me aktin nr. 6498 prot., datë 10.11.2017, Komisioni i Ristrukturimit, vendosi t'i propozojë DAP mundësinë për transferimin e përhershëm të 188 nëpunësve civilë, në pozicionet e reja të krijuara pas ristrukturimit. Në vijim të propozimit të mësipërm, Komisioni i Ristrukturimit pasi mori në shqyrtim vendet e mbetura vakante në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, së bashku me kriteret specifike për secilin pozicion pune dhe të dhënat e nëpunësve civilë, vendet e të cilëve preken si pasojë e ristrukturimit (dosjet individuale) vendosi t'i propozojë DAP, me aktin nr. 6498/190 prot., datë 24.11.2017, mundësinë për transferimin e përhershëm edhe të 9 nëpunësve civilë, me aktin nr. 6498/193 prot., datë 24.11.2017, transferimin e përhershëm edhe të 5 nëpunësve civilë, nr. 6498/204 prot., datë 24.11.2017, transferimin e përhershëm edhe të 1 nëpunësi civil, në pozicionet e reja të krijuara pas ristrukturimit të institucionit.

Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se, nëpunësit në mënyrë shpresore kanë dhënë miratimin e tyre për transferimin dhe nuk ka asnjë rast refuzimi në lidhje me vendimin e transferimit të nëpunësve, si rezultat i ristrukturimit, sikurse parashikohet në dispozitat ligjore. Vendimi përfundimtar i marrë nga njësia përgjegjëse, “*Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit*”, si dhe deklarata e nëpunësit të transferuar që shpreh miratimin lidhur me transferimin, janë të administruara në dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil.

Në mënyrë të përmbledhur me tabela, jepet situata e ristrukturimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si më poshtë:

➤ **Tabela nr. 1. Punonjësit e larguar me transferim të përhershëm**

Nr.	Emër mbiemër, pozicioni i punës	Ndërprerjet financiare me MIE
1.	*****, në pozicionin Përgjegjës në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Redaktimit Gjuhësor, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, në ish-Ministrinë e Zhvillimit Urban, për shkak të transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit institucional, kalon në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit	Me urdhrin nr. 279, datë 07.12.2017, marrëdhëniet financiare janë prerë në datën 07.12.2017
2.	*****, në pozicionin Specialist në Sektorin e Licencimit, Drejtoria e Standardeve Urbane dhe Antikorupsionit, në ish-Ministrinë e Zhvillimit Urban, për shkak të transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit institucional, kalon në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit	Me urdhrin nr. 258, datë 05.12.2017, marrëdhëniet financiare janë prerë në datën 01.12.2017
3.	*****, në pozicionin Specialist në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Redaktimit Gjuhësor, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, në ish-Ministrinë e Zhvillimit Urban, për shkak të transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit institucional, kalon në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit	Me urdhrin nr. 260, datë 05.12.2017, marrëdhëniet financiare janë prerë në datën 01.12.2017

4.	*****, në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Ndërtimeve Informale, Legalizimit dhe Urbanizimit, në ish-Ministrinë e Zhvillimit Urban, për shkak të transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit institucional, kalon në Ministrinë e Drejtësisë	Me urdhrin e datës 19.12.2017 marrëdhëniet financiare janë prerë në datën 23.12.2017
5.	*****, në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, në ish-Ministrinë e Zhvillimit Urban, për shkak të transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit institucional, kalon në Ministrinë e Drejtësisë	Me urdhrin e datës 19.12.2017 marrëdhëniet financiare janë prerë në datën 23.12.2017
6.	*****, në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Financës, në ish-Ministrinë e Zhvillimit Urban, për shkak të transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit institucional, kalon në Ministrinë e Drejtësisë	Me urdhrin e datës 19.12.2017 marrëdhëniet financiare janë prerë në datën 23.12.2017
7.	*****, në pozicionin Drejtor të Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Urban, në ish-Ministrinë e Zhvillimit Urban, për shkak të transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit institucional, në pozicionin Koordinator, në Kryeministri	Me urdhrin nr. 367, datë 21.12.2017, marrëdhëniet financiare janë prerë në datën 19.12.2017
8.	*****, në pozicionin Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Programeve të Zhvillimit të Telekomunikacionit dhe Postave, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit, për shkak të transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit institucional, kalon në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike	Me urdhrin nr. 145/2, datë 31/01/2018, marrëdhëniet financiare janë prerë në datën 12.02.2018
9.	*****, në pozicionin Specialist, në Sektorin e Programeve të Zhvillimit të Telekomunikacionit dhe Postave, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit, për shkak të transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit institucional, kalon në Ministrinë e Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike	Me urdhrin nr. 145/2, datë 31.01.2018, marrëdhëniet financiare janë prerë në datën 12.02.2018

➤ **Tabela nr. 2. Punonjës të ardhur me transferim të përhershëm**

Nr.	Emër mbiemër	Institucioni nga ka ardhur	Urdhri i transferimit
1.	*****	Ish-Ministria e Mjedisit	Urdhri nr. 375, datë 22.12.2017
2.	*****	Kryeministria	Urdhri nr. 375, datë 22.12.2017
3.	*****	Ish-Ministria e Mjedisit	Urdhri nr. 375, datë 22.12.2017
4.	*****	Ish-Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes	Urdhri nr. 375, datë 22.12.2017
5.	*****	Ish-Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes	Urdhri nr. 375, datë 22.12.2017
6.	*****	Ish-Ministria e Mjedisit	
7.	*****	Ish-Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes	Urdhri nr. 375, datë 22.12.2017
8.	*****	Ish-Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes	Urdhri nr. 375, datë 22.12.2017

9.	*****	Ish-Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes	Urdhri nr. 375, datë 22.12.2017
----	-------	--	---------------------------------

➤ **Tabela nr. 3. Punonjës me lirim nga shërbimi civil për shkak të kalimit në strukturën e AKSH-it**

Nr.	Emër mbiemër	Ndërprerjet financiare me MIE
1.	*****	Në datë 11.11.2017
2.	*****	Në datë 11.11.2017
3.	*****	Në datë 11.11.2017
4.	*****	Në datë 11.11.2017

Në lidhje me pozicionet, ku këta nëpunës kanë qenë të emëruar, grupi i punës konstaton se në strukturën aktuale të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nuk është parashikuar njësia organizative e njësisë së teknologjisë së informacionit, fakt që nënkupton se këto pozicione janë suprimuar. Në lidhje me këtë rrethanë, rezulton se, në zbatim të vendimit nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, strukturat përgjegjëse TIK në institucionet e administratës shtetërore, nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, bëhen pjesë e strukturës së AKSHI-t.

Në pikën 23, të këtij akti nënligjor, përcaktohet se, punonjësit aktuale të njësive të teknologjisë së informacionit e të komunikimit (NJTIK), në këtë institucione, kalojnë tek AKSHI brenda datës 23.12.2013 dhe këta nëpunës trajtohen në bazë të përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nëpunësit civilë, në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit, apo Kodit të Punës.

Në lidhje me sa më sipër, grupi i punës vëren se, vendimet e Komisionit të Ristrukturimit, për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, në rastin e nëpunësve \*\*\*\*\* ,\*\*\*\*\* ,\*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , janë marrë në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi.

Konstatohet se në aktin e lirimit nga shërbimi civil, nëpunësve të mësipërm, u është njohur e drejta e dëmshpërblimit në përputhje me vjetërsinë e punës si e drejtë e përcaktuar në nenin 50, pika 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Nga ana tjetër, konstatohet se, Departamenti i Administratës Publike, me qëllim garantimin e të drejtave të këtyre punonjësve, të liruar nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit, i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit duke kërkuar fillimin e procedurave për vijimin e marrëdhënies së punës për punonjësit e mësipërm, sipas përcaktimeve të aktit nënligjor që rregullon këtë aspekt.

➤ **Tabela nr. 4. Punonjës të larguar me transferim të përkohshëm**

Nr.	Emer mbiemer	Ndërprerjet financiare me MIE
1.	***** , në pozicionin Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Programimit, Hartimit dhe Harmonizimit të Akteve	Në datë 06.11.2017, kalon në Autoritetin Rrugor Shqiptar

	Rregullatore, Drejtoria e Programimit , Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në ish-Ministrinë e Zhvillimit Urban	
2.	*****, në pozicionin Specialist në Sektorin e Arkiv-protokollit, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në ish-Ministrinë e Zhvillimit Urban	Në datë 01.12.2017, kalon në Ministrinë e Drejtësisë
3.	*****, në pozicionin Përgjegjës Sektori i Përgatitjes së Fisibilitetit të Projekteve IPA, në Drejtorinë e Konceptimit dhe Fisibilitetit të Projekteve të Industrisë dhe Energjisë, në ish-Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë	Në datë 01.12.2017, kalon në Ministrinë e Drejtësisë
4.	*****, në pozicionin Specialist në Sektorin e Këshillimit Ligjor dhe Monitorimit të Impakteve të Akteve Rregullatore, Drejtoria e Programimit , Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në ish-Ministrinë e Zhvillimit Urban	Në datë 31.12.2017, kalon në Ministrinë e Turizmit
5.	*****, në pozicionin Specialist në Sektorin e Programimit, Hartimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, Drejtoria e Programimit , Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në ish-Ministrinë e Zhvillimit Urban	Në datë 08.01.2018, kalon në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
6.	*****, në pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Bashkepunimit, Marrëveshjeve dhe Kontratave, në Drejtorinë e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës, në ish-Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë	Në datë 31.12.2017, kalon në Komitetin e Minoriteteve, pranë Këshillit të Ministrave
7.	*****, në pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Arkiv-Protokollit, në ish-Ministrinë e Zhvillimit Urban	Në datë 01.12.2017, kalon në Ministrinë e Drejtësisë

➤ **Tabela nr. 5. Punonjës të ardhur me transferim të përkohshëm**

Nr.	Emër mbiemër	Institucioni nga ka ardhur
1.	*****, në pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Standardeve të Tregut dhe Sigurisë Teknike në fushën e Industrisë, në MIE	Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve
1.	*****, në pozicionin Specialist në sektorin e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Energjisë dhe Industrisë, në MIE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë

➤ **Tabela nr. 6. Punonjës të larguar me dorëheqje**

Nr.	Emër mbiemër	Ndërprerjet financiare me MIE
1.	*****, në pozicionin Drejtor Auditi, në ish-Ministrinë e Zhvillimit Urban	Në datë 13.11.2017
2.	*****, në pozicionin IT, në ish-Ministrinë e Zhvillimit Urban	Në datë 23.11.2017
3.	*****, në pozicionin Specialist, në ish-Ministrinë	Në datë 20.11.2017



	eInfrastrukturës dhe Transporteve	
4.	*****, në pozicionin Specialist, në ish-Ministrinë e e Zhvillimit Urban	Në datë 12.01.2018

➤ **Tabela nr. 7. Punonjës të pezulluar me këkesën e tyre nga shërbimi civil**

Nr.	Emër mbiemër	Ndërprerjet financiare me MIE
1.	*****, nëpozicionin Përgjegjës në Sektorin e Lejeve dhe Monitorimit të Hidrokarbureve në Drejtorinë e Politikave dhe Zhvillimit të Hidrokarbureve, në ish-Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë	Në datë 06.11.2017
2.	*****, në pozicionin Drejtor në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në ish-Ministrinë e Zhvillimit Urban	Në datë 1 dhjetor 2017
3.	*****, në pozicionin Specialist në Sektorin e Programimit, Hartimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në ish-Ministrinë e Zhvillimit Urban	Në datë 1 shkurt 2018
4.	*****, në pozicionin Drejtor, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Infrastrukturës dheTerritorit, në ish-Ministrinë e Zhvillimit Urban	Në datë 15 shkurt 2018
5.	*****, në pozicionin Specialist Sektorin e Programimit, Hartimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, në ish-Ministrinë e Zhvillimit Urban	Në datë 1 Mars 2018
6.	*****, në pozicioninSpecialist në Sektorin e Monitorimit, Jetësimi të Prioriteteve dhe Statistikave në Fushën e Industrisë dhe Energjisë, në ish-Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë	Në datë 6 Mars 2018

Përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil, si rezultat i mbylljes apo ristrukturimit, është parashikuar nga neni 50, pika 6 dhe 66, pika 1, germa a/1, e ligjit nr.152.2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si një nga rastet e lirit nga shërbimi civil.

Gjatë verifikimit të procesit të ristrukturimit që kaloi institucioni, e evidentuan 9 raste, për të cilat është vendosur lirimi nga shërbimi civil, për këtë shkak. Për këto raste është treguar kujdes i veçantë për respektimin e të gjitha të drejtave që parashikon pika 7 e neni 50 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësit civil”, të ndryshuar, për punonjësit të cilët lirohen nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit, ndër të cilat e drejta e dëmshpërblimit në përputhje me vjetërsinë në punë, e drejta për të konkurruar për një periudhë 2 vjeçare në procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe e drejta për t`u emëruar në mënyrë të përkohshme nga njësia përgjegjëse, me pëlqimin e tyre, në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil.

➤ **Tabela nr. 8. Punonjësve të larguar nga shërbimi civil**

Nr.	Emër mbiemër, pozicioni i punës	Ndërprerjet financiare me MIE dhe urdhri përkatës për dëmshpërblim
1.	*****, në pozicionin Drejtor, Drejtoria e Shërbimeve Juridike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, në ish Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.	Me urdhrin nr. 311, datë 12.12.2017, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil dhe me urdhrin nr.362, datë 21.12.2017, është dëmshpërblyer sipas ligjit në masën e gjashtë pagave mujore, për vjetërsi në shërbimin civil, gjithsej 4 (katër) vite e 2 (dy) muaj.
2.	*****, në pozicionin Drejtor, Drejtoria e Politikave të Transportit në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave, në ish Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.	Me urdhrin nr. 368, datë 21.12.2017, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil dhe me urdhrin nr.361, datë 21.12.2017, është dëmshpërblyer sipas ligjit në masën e tre pagave mujore, për vjetërsi në shërbimin civil, gjithsej 2 (dy) vite e 7 (shtatë) muaj.
3.	*****, në pozicionin Drejtor, Drejtoria e Licencimit dhe Rregullave të Ndërtimit, Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve dhe Monitorimit, në ish Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.	Me urdhrin nr. 312, datë 12.12.2017, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil dhe me urdhrin nr.363, datë 21.12.2017, është dëmshpërblyer sipas ligjit në masën e gjashtë pagave mujore, për vjetërsi në shërbimin civil, gjithsej 3 (tre) vite e 9 (nëntë) muaj.
4.	*****, në pozicionin Drejtor, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, në ish Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.	Me urdhrin nr. 314, datë 12.12.2017, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil dhe me urdhrin nr.360, datë 21.12.2017, është dëmshpërblyer sipas ligjit në masën e dymbëdhjetë pagave mujore, për vjetërsi në shërbimin civil, gjithsej 15 (pesëmbëdhjetë) vite e 8 (tetë) muaj.
5.	*****, në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit në ish Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë	Me urdhrin nr. 370, datë 21.12.2017, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil dhe me urdhrin e datës 21.12.2017, është dëmshpërblyer sipas ligjit në masën e dymbëdhjetë pagave mujore, për vjetërsi në shërbimin civil, gjithsej 16 (gjashtëmbëdhjetë) vite
6.	*****, në pozicionin Drejtor, Drejtoria e Integritimit Evropian dhe Projekteve, në ish Ministrinë e Zhvillimit Urban.	Me urdhrin nr. 315, datë 12.12.2017, është vendosur përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil dhe me urdhrin nr. 364, datë 21.12.2017, është dëmshpërblyer sipas ligjit në masën e gjashtë pagave mujore, për vjetërsi në shërbimin civil, gjithsej 3 (tre) vite e 9 (nëntë) muaj.
7.	*****, në pozicionin Drejtor të Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Urban, në ish Ministrinë e Zhvillimit	Me urdhrin nr. 133, datë 30.01.2018, marrëdhëniet financiare janë prerë në

	Urban.	datën 31.01.2018 dhe me urdhrin nr.134, datë 30.01.2018, është dëmshpërblyer sipas ligjit në masën e dymbëdhjetë pagave mujore, për vjetërsi në shërbimin civil, gjithsej 15 (pesëmbëdhjetë) vite
8.	*****, në pozicionin Specialist, në Sektorin e Planifikimit të Buxhetit, në ish Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës.	Me urdhrin e datës 21.12.2017, marrëdhëniet financiare janë prerë në datën 19.12.2017 dhe me urdhrin nr. 359 datë 21.12.2017, është dëmshpërblyer sipas ligjit në masën e dymbëdhjetë pagave mujore, për vjetërsi në shërbimin civil, gjithsej 17 (shtatëmbëdhjetë) vite
9.	*****, në pozicionin Drejtor, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, në ish-Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë	Me urdhrin nr. 145/3, datë 13.02.2018, marrëdhëniet financiare janë prerë në datën 12.02.2018 dhe me urdhrin nr.364, datë 21.12.2017, është dëmshpërblyer sipas ligjit në masën e dymbëdhjetë pagave mujore, për vjetërsi në shërbimin civil, gjithsej 11 vite e 10 muaj (njëmbëdhjetë vite e dhjetë muaj).

➤ **Tabela nr. 9. Punonjës, të cilët kanë bërë ankim në Gjykatën Administrative**

Nr.	Emër mbiemër, pozicioni i punës	Përfundimi i çështjes gjyqësore
1.	*****, në pozicionin Drejtor, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, në ish Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.	
2.	*****, në pozicionin Drejtor, Drejtoria e Politikave të Transportit në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave, në ish Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.	Fituar institucioni në shkallë të parë
3.	*****, në pozicionin Drejtor, Drejtoria e Shërbimeve Juridike, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, në ish Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.	
4.	*****, në pozicionin Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve dhe Monitorimit, në ish Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.	Fituar institucioni në shkallë të parë
5.	*****, në pozicionin Drejtor, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në ish-Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë	

Në kuadër të procesit të verifikimit, grupi i punës konstatoi se këta nëpunës aktualisht i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me kërkesë padi, duke kërkuar shfuqizimin e akteve administrative të sipërcituara, si dhe rregullimin e pasojave juridike si pasojë e konstatimit të paligjshmërisë së këtyre akteve, për të bërë të mundur rikthimin e tyre në pozicionin e mëparshëm ose në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori.

Në rastin e këtyre punonjësve, për të cilët është vendosur lirimi nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit, vlerësohet se kjo çështje do të marrë zgjidhje përfundimtare në rrugë gjyqësore, pasi mosmarrëveshja administrative në lidhje me marrëdhënien e shërbimit civil në një rast ristrukturimi, është objekt për t'u shqyrtuar në Gjykatën Administrative, si organi kompetent në këtë rast në përputhje me nenin 41, pika 3, të ligjit për nëpunësin civil.

- ***Në lidhje me kërkesën e paraqitur nga nëpunësja \*\*\*\*\* , për lirimin e saj nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit***

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është regjistruar kërkesë/ankesa me nr. 354 prot., datë 21.03.2018, e ardhur nga nëpunësja \*\*\*\*\* , në pozicionin e punës, “*Drejtor, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në ish-Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë*”, përmes së cilës ajo e konsideron të padrejtë vendimin për lirimin e saj nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit.

Nëpunësja \*\*\*\*\* pretendon se pozicioni i saj i punës nuk është suprimuar, por i ka ndryshuar vetëm emërtesa dhe aktualisht quhet Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve.

Nga përmbajtja e materialeve të administruara gjatë monitorimit të zbatimit të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe të akteve nënligjore, gjatë aplikimit të procedurave në lidhje me procesin e ristrukturimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë rezultoi se, nëpunësja \*\*\*\*\* , ka kryer detyrën “*Drejtor, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në ish-Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë*”, pozicioni i cili me strukturën e re të miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 160, datë 05.10.2017, “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë*”, nuk ekziston më.

Komisioni i Ristrukturimit, në pamundësi të sistemimit të nëpunëses \*\*\*\*\* , në një pozicion të së njëjtës kategori, i ka propozuar sistemimin në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Programeve të Zhvillimit në Fushën e Industrisë, të cilin nëpunësja në fjalë e ka refuzuar.

Në bazë të Vendimit të Komisionit të Ristrukturimit nr. 2625 prot., datë 08.02.2018, “*Për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të \*\*\*\*\**”, ka dalë urdhri i Ministrit nr.145/3, datë 13.02.2018, për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të nëpunëses në fjalë, kurse me urdhrin e Ministrit nr. 364, datë 21.12.2017, nëpunësja \*\*\*\*\* është dëshmipërblyer sipas ligjit në masën e dymbëdhjetë pagave mujore, për vjetërsi në shërbimin civil, gjithsej 11 vite e 10 muaj (njëmbëdhjetë vite e dhjetë muaj).

Në kuadër të procesit të verifikimit, konstatohet se *kjo nëpunëse aktualisht i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*, me kërkesë padi, duke kërkuar shfuqizimin e aktit administrativ nr. 2625 prot., datë 08.02.2018, të Komisionit të Ristrukturimit. Në këto rrethana, bazuar në parimin e sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr. 8116 datë 29.3.1996 “*Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë*”, që institucionet e tjera nuk mund të trajtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga

sistemi gjyqësor, si dhe në kushtet kur kjo çështje do të marrë një zgjidhje përfundimtare nga gjykata, vlerësojmë se në këtë rast, nuk duhet të vijojë më tej hetimi administrativ dhe çështja duhet të arkivohet.

### **III. Roli i Departamentit të Administratës Publike**

Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 6404/1, datë 8.11.2017, “Mbi transferimin e nëpunësve për shkak të ristrukturimit në Institucionit të Ministrisë së Mbrojtjes”, ka vijuar me procesin e nxjerrjes së vendimit të transferimit. Vendimet individuale të transferimit i janë njoftuar çdo nëpunësi të prekur nga ristrukturimi dhe janë administruar në dosjet e personelit.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se, pëlqimet e punonjësve të transferuar janë të administruara në dosjet e personelit, në mënyrë shkresore në formën e deklaratave. Nuk konstatohet asnjë rast refuzimi në lidhje me vendimin e transferimit të nëpunësve, si rezultat i ristrukturimit, e cila është një drejtë ligjore e nëpunësit civil, që parashikohet në dispozitat ligjore.

Gjithashtu rezulton se, në këtë institucion nuk është liruar nga shërbimi civil asnjë nëpunës civil, si pasojë e ristrukturimit sipas përcaktimeve të nenin 50, ligjit nr. 152.2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

### **IV. Respektimi i afateve gjatë aplikimit të procedurës së ristrukturimit nga Komisioni i Ristrukturimit dhe Departamenti i Administratës Publike**

Një moment tjetër i mbikëqyrjes së procesit të ristrukturimit së aplikuar pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, është verifikimi i afateve të përcaktuara në legjislacionin specifik që rregullon këtë aspekt.

Si rregull, njësia e burimeve njerëzore e institucionit, në momentin e miratimit të aktit të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit, njofton individualisht nëpunësit për fillimin e procedurës së transferimit apo përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit. Efektet financiare për nëpunësit që do të transferohen apo do t’u përfundojë marrëdhënia e punësimit, fillojnë jo më shpejt se 1 (një) muaj nga momenti i njoftimit. (pika 15 e kreut II, të VKM nr. 125, dt. 17.2.2016). Rezulton se ky afat është respektuar nga Departamenti i Administratës Publike.

Më tej, është parashikuar se, nëpunësi më i lartë civil i institucionit në ristrukturim, jo më vonë se 2 ditë pas hyrjes në fuqi të aktit që ka miratuar ristrukturimin, i kërkon njësisë përgjegjëse (DAP), nxjerrjen e aktit për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit. Njësia përgjegjëse (DAP), brenda 2 ditëve nga marrja e kërkesës krijon Komisionin e Ristrukturimit (sipas përcaktimeve të pikave 1, 1/1 e 2, të kreut II, të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike).

Pasi krijohet nga njësia përgjegjëse, Komisioni Ristrukturimit brenda 15 ditëve, nga momenti i krijimit të tij, i propozon njësisë përgjegjëse (DAP), vendimet mbi transferimin e nëpunësve civil (sipas

*përcaktimeve të pikës 16, të kreut II, të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, të Departamentit të Administratës Publike).*

Në vazhdim, njësia përgjegjëse, brenda 10 ditëve, nga data e marrjes së propozimit për transferimin e nëpunësve civil nga Komisioni i Ristrukturimit, vendos për miratimin e propozimeve në fjalë, ose kthimin e akteve Komisionit në rastet kur vërtetohet parregullsi ligjore, i cili e rishqyrton brenda 5 ditëve (*sipas pikës 20, Kreu II, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, si dhe si dhe pikës 18, të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, i DAP).*

Në këtë rast, aktet nënligjore kanë parashikuar edhe njoftimin e vendimit të transferimit të nëpunësit civil që transferohet dhe marrjen e mendimit të tij me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit; të drejtën e nëpunësit që të refuzojë vendimin dhe të dëgjohet nga njësia përgjegjëse brenda 5 ditëve dhe pas kësaj rikthimin e akteve për rivlerësim Komisionit, i cili duhet të japë mendimin e tij brenda 5 ditëve (*sipas pikës 20 e 21 të kreut II, të vendimit nr. 125, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, si dhe si dhe pikës 19, 20 e 21 të udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016, i DAP).*

Në këto rrethana, nëse do të aplikoheshin të gjitha fazat e procesit të ristrukturimit, si dhe afatet procedurale të ankimit, si dhe duke llogaritur vonesat në marrjen e njoftimit nga subjektet e përcaktuara në aktet rregullative të përmendura më sipër, atëherë i gjithë ky proces parashikohet që të kryhet brenda një afati kohor që zgjat rreth 60 ditë kalendarike.

Për sa është parashtruar në përmbajtje të këtij relacioni, rezulton se, ristrukturimi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, është bërë me Urdhrin e Kryeministrit nr. 160, datë 05.10.2017, "*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë*". Komisioni i ristrukturimit është ngritur në datën 09.10.2017. Procedurat e sistemimit të nëpunësve nëpërmjet transferimit të përhershëm; nxjerrja e akteve të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit; si dhe, njoftimi i nëpunësve përkatës pozicionet e të cilëve u prekën nga ristrukturimi kanë përfunduar në datën 29.12.2018. (Në tërësi procedura është realizuar për 60 ditë).

Në dispozitat ligjore që rregullojnë procedurën e ristrukturimit, ligjvënësi ka përcaktuar të vendosë afatet procedurale të përmendura më sipër, për të disiplinuar këtë proces me qëllim që procesi të mos zvarritet. Megjithatë, vlen të theksohet se, afati i mësipërm ligjor shërben si një garant në kushtet e zhvillimit të një procesi ristrukturimi në rrethana të zakonshme. Në rastin konkret, për sa është pasqyruar në përmbajtjen e këtij relacioni, rezulton se ndodhemi në kushtet e riorganizimit tërësor të aparatit shtetëror, i cili është shoqëruar me ndryshim të theksuar të mënyrës së funksionimit të ministrive, misionit të tyre si dhe të riformatimit të njësive organizative, fakt që kërkon një periudhë më të gjatë kohore të realizimit të procedurës së ristrukturimit.

Në rastin konkret grupi i punës vlerëson se, aplikimi i procesit të ristrukturimit nga aktorët e caktuar nga ligji është realizuar brenda afateve ligjore, duke përmbyllur këtë proces pa zvarritje.

## V. Konkluzione

Nga gjithë sa analizuam më sipër, Komisioneri vlerëson se, Komisioni i Ristrukturimit është krijuar në përputhje me kërkesat e nenit 50, pika 3 e 5, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; vendimin nr. 125, datë 17.2.2016 i Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”* si dhe udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, i ndryshuar të Departamentit të Administratës Publike, *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”*, në lidhje me procesin e ristrukturimit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Procedura e ndjekur nga Komisioni i Ristrukturimit, duke analizuar strukturën dhe organikën e re të miratuar, si dhe strukturat dhe organikat e mëparshme të 3 ministrive të riorganizuara, është në përputhje me ligjin, duke u shqyrtuar mundësia e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese, brenda institucionit si dhe në institucionet e varësive.

Komisioneri konstaton se, nëpunësit civil të përfshirë në ristrukturim nuk e kanë refuzuar vendimin përfundimtar për transferimin në kuadër të ristrukturimit, ç’ka provohet me miratimin e shprehur në deklaratat e depozituara pranë Drejtorisë së Mirë administrimit të Burimeve Njerëzore, me përjashtim të 5 rasteve, që janë ankuar në gjykatë dhe janë trajtuar më sipër.

## VI. Detyrat e lëna dhe Rekomandimet

Në përfundim të procesit të monitorimit lidhur me veprimet administrative që janë kryer në kuadër të ristrukturimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Komisioneri vlerëson se nga ana e institucionit duhet të kryhen këto detyra:

- ✓ Njësia e burimeve njerëzore e institucionit në bashkëpunim me njësinë përgjegjëse DAP, të finalizojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar dhe lidhjeve pjesë e këtij vendimi.

\*  
\*                      \*

Këto ish-in rrethanat e konstatuara gjatë procesit të monitorimit të procedurave të kryera në kuadër të ristrukturimit të institucionit Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në lidhje me zbatimin e ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.

Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe njësia përgjegjëse, duhet të marrin masat për të realizuar detyrat e lëna nga Komisioneri në këtë Raport, për të finalizuar sa më shpejt procesin e hartimit dhe

miratimit të përshkrimeve të punës, me qëllim përmirësimin e situatës në administrimin e shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**